



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e premte, datë 19.06.2026, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Rinovimin e licencës së shoqërisë “ALB-CRTV” sh.p.k, për subjektin audio me përsëritës “Radio CRI” (Radio e Jashtme e Kinës), për një periudhë 7 (shtatë) vjeçare.
(Vendimi nr. 55, datë 19.06.2026)
2. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Vodafone Albania” sh.a., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Vodafone TV”, për reduktimin e zonës së ofrimit të subjektit.
(Vendim nr. 56, datë 19.06.2026)
3. Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 14 datë 18.05.2026 për dënimin me gjobë, të shoqërisë “Media Nord” sh.a, licencuar për subjektin OSHMA “Tv Channel 1”.
(Vendimi nr. 57, datë 19.06.2026)
4. Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 4 datë 27.04.2026, për dënimin me gjobë, të shoqërisë “Telegraf Televizion” sh.a, licencuar për subjektin OSHMA “Telegraf News”.
(Vendimi nr. 58, datë 19.06.2026)
5. Përfundimin e procedurës “Mbi përcaktimin e frekuencave për shërbimin e transmetimit audio analoge dhe çeljen e garës për dhënien e 1 (një) licence transmetimit audio analoge në “Qarkun Shkodër”, pa aplikant.
(Vendimi nr. 59, datë 19.06.2026)

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 19 Qershor 2026